

Reagimi Fillestar i TAP-it Lidhur me Raportin e Bankwatch “Të të Hedhin Hi Syve: Përse premtimet e Korridorit Jugor të Gazit nuk qëndrojnë”

Raporti “Të të Hedhin Hi Syve: Përse premtimet e Korridorit Jugor të Gazit (KJG) nuk qëndrojnë” botuar në janar të vitit 2018, përqendrohet në emetimet e rrjedhjes së metanit. Raporti synon të vlerësojë në mënyrë sasiore rëndësinë e mundshme të këtyre emetimeve nga KJG. Duke qenë se raporti përqendrohet vetëm në emetimet e rrjedhjes së metanit, ai nuk njihet përfitimet e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) për vendet pritëse, masat mjedisore dhe sociale për të shtuar në maksimum përfitimet për komunitetet vendore dhe rolin e gazit në reduktimin e shkarkimeve nga burime të tjera energjetike, si qymyri. Për më tepër, ai nuk njihet masat e ndërmarra nga TAP-i për të ulur dhe zvogëluar shkarkimet e gazrave serrë përmes projektimit, ndërtimit dhe proceseve të ardhshme të operimit të TAP-it.

Këto masa përfshijnë sa më poshtë:

- Përzgjedhjen e pajisjeve me djegie operationale të Teknologjisë më të Mirë të Disponueshme (BAT), të cilat përmbushin kufijtë e efektshmërisë së energjisë të përcaktuara në kuadrin e dokumenteve referencë të BE-së për BAT, njohur si BREF.
- Masat e përfshira në projektim për të ulur emetimin e metanit, përfshirë instrumentet me integritet të lartë, fashetat dhe valvulat me shkarkim të ulët, si dhe sistemet e ripërdorimit të gazit.
- Përdorimin e energjisë nga rrjeti kombëtar në ato raste kur kërkesë/oferta janë në përputhje.
- Kontrollin optimal operacional dhe programimin për minimizimin e ajrosjeve.
- Monitorimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin proaktiv dhe të rregullt përgjatë tubacionit për të siguruar ruajtjen e efektshmërisë së djegies në impiant dhe minimizimin e emetimeve të rrjedhjes.
- Raportimin e emetimeve të gazrave serrë për të mbështetur performancën e efektshme të energjisë, raportimin dhe përmirësimet.

Studimet e detajuara inxhinierike të kryera nga shoqëritë ndërkombëtare inxhinierike dhe të certifikimit për vlerësimin e emetimeve të mundshme të rrjedhjes lidhur me TAP-in, që kanë parashikuar emetime vjetore të rrjedhjes së metanit të cilat përfaqësojnë humbje prej 0,008% krahasuar me volumin e transportuar në tubacion. Humbjet janë jashtëzakonisht të ulëta, duke treguar efektshmërinë e masave të ndërmarra në projektim, dhe ato janë brenda kufijve të përcaktuar nga World Energy Outlook i vitit 2017 i IEA në mënyrë që gazi të sjellë përfitime mjedisore krahasuar me qymyrin. Humbjet e përlogaritura nga studimet e detajuara inxhinierike janë shumë më të ulëta se përlogaritjet për humbjet e përgjithshme të metanit prej 0,5 deri 6% të përfshira në raportin e BankWatch.

Aspektet kyçe më poshtë paraqesin më tej rëndësinë e KJG dhe të TAP-it në veçanti:

- Gazi natyror është i përbalueshëm, gjithnjë e më shumë i disponueshëm, i sigurt, si dhe një formë energjie me përmbajtje relativisht të ulët karboni, që do të jetë një pjesë e rëndësishme e përzjerjes së alternativave energjetike në periudhën afatgjatë për të përballuar sfidën energjetike botërore.

- Ndërkohë që Evropa ecën përpara drejt një të ardhme me shkarkime të ulëta karboni, ajo vazhdon të ketë nevojë për energji të mjaftueshme dhe të përbalueshme nga një llojshmëri burimesh, në mënyrë që të ushqejë ekonominë e saj, të ngrohë banesat e saj dhe të vazhdojë të jetë konkurruese.
- Sipas strategjisë së Komisionit Evropian, çdo shtet anëtar duhet të ketë akses në të paktën tre burime të ndryshme furnizimi me energji. Në këtë kuadër, burimet nga rajoni kaspik janë mundësia e madhe e ardhshme për kontinentin. TAP-i mund të lidhet me vepra kyçe infrastrukture, si Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) dhe Interkonektori Greqi-Bullgari (IGB), duke sjellë burime të reja gazi për vendet që aktualisht varen nga një burim i vetëm energjie, ose që nuk kanë fare akses në gaz.
- Një tjetër pikë e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë është se gazi që transportohet nga TAP-i përfaqëson rreth 40% të nevojave të Bullgarisë (1bcm/vit), një të pestën e nevojës së Greqisë (1bcm/vit), dhe rreth 12% të nevojës së Italisë për gaz.
- Furnizimet e reja me gaz do të ndikojnë në konkurrencën në sektorin e gazit, duke siguruar një mjedis më konkurrues për konsumatorin fundor.
- Gazi natyror i transportuar nga TAP-i do të japë kontribut për shkarbonizimin e ekonomive, veçanërisht në Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor, ku sektori i energjisë është tejet i varur nga përdorimi i hidrokarbureve të rënda fosile, qymyrit dhe linjtit për prodhim energjie. Kërkesa për gaz pritet të rritet ndërkohë që zëvendëson lëndë djegëse si qymyri dhe druri që përdoren rëndom në rajon.
- Realizimi i TAP-it dhe hapja e KJG është një hap historik në drejtim të diversifikimit të furnizimit. Do të jetë një arritje kritike në hapjen e një rruge të re dhe për përforcimin e sigurisë së energjisë në Evropë.
- Aktualisht, pjesa më e madhe e Evropës varet nga qymyri dhe nga shkarkimet e tij të konsiderueshme të gazrave serrë. Megjithatë, IEA ka pritshmëri që një e treta e termocentraleve të Evropës që punojnë me qymyr të mbyllin në pesë vitet e ardhshme, duke krijuar kështu një mundësi që gazi të ketë një pjesë më të madhe të tregut. Gazi natyror shkarkon 50% më pak dioksid karboni se sa qymyri, kur digjet për prodhim energjie.
- Vende të tjera, si Gjermania, prodhojnë energji me centrale bërthamore, por gjithashtu planifikojnë t'i mbyllin ato gradualisht dhe të shtojnë konsiderueshëm sasinë e energjisë së rinovueshme që përdorin, në përpjekje për të zhvilluar një prodhim më të qëndrueshëm energjie dhe për të ulur shkarkimet e gazrave serrë. Gazi natyror është partneri i përsosur i energjisë së rinovueshme dhe gjithashtu mund të luajë rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Për më tepër, natyra e çrregullt e burimeve të energjisë së rinovueshme krijon nevojën për prodhim fleksibël të energjisë. Gazi natyror është partner i përsosur për burimet e rinovueshme në këtë aspekt. Kështu, gazi natyror do të mbetet një përbërës jetik i përzjerjes së burimeve të energjisë dhe zhvillimi i infrastrukturës moderne të gazit natyror duhet të promovohet më tej.
- Zhvillimi i energjive të rinovueshme është jetik, por ky proces mund të jetë i ngadaltë dhe i kushtueshëm, dhe burimet e rinovueshme kërkojnë subvencione të konsiderueshme dhe mbështetje qeveritare për të arritur maturi në treg. Si rrjedhojë, ka nevojë kritike për kalim nga energjia e përqendruar në burime karboni në lëndët fosile më të pastra, si gazi natyror, për të arritur synimet klimatike të vendeve të ndryshme.